

U21/ Hungari – Shqiperi 0-2

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 14 Nentor 2013 20:37



Shqiperia e 21-vjecareve ka shperthyer ne Budapest duke regjistruar fitoren e pare, ne kete edicion eliminator te Kampionatit European. Djemte e drejtuar nga trajneri Skender Gega, kane zhvilluar nje ndeshje mjaft te mire, ndaj nje kundertshtari te forte, qe na kishte mundur ne Durres me rezultatin 2-1. Skuadra shqiptare luajti mjaft e mobilizuar, duke kontrolluar ndeshjen ne meyre qe te mos vinte ne rrezik porten e Teqes. Te udhehequr nga Ergys Kace i cili ishte lojtari me i mire ne fushe, kuqezinjte e vegjel ja kane dale te mposhtin hungarezet. Ka qene Shkurtaj, ai qe ne minuten e 75 ka zhbllokuar rezultatin, duke e bere skuadren me krahe. Trajneri Gega nderhyn nga pankina duke bere nderrime qe rezultuan efikase. Tete minuta pas golit te pare, Shqiperia U-21 godet perseri. Autor i golit te dyte eshte Shala. Me pas nuk ka me histori, megjithe perpjekjet e deshperuara te vendasve. Ndeshja mbyllet me rezultatin 0-2 dhe 21-vjecaret regjistrojne fitoren e pare. Nje fitore e rendesishme qe shkon dhe si dhurate per Gegen qe festoi ditelindjen e tij.

Hungari-Shqiperi 0-2

Stadiumi “Jozef Bozsik” Budapest

Hungaria: Jova, Lang, Kelemen, Szolnoki, Poor, Windecker, Rado, Szakaly, Adorjan (‘63 Kleinheister), Kovacs (‘84 Vernes), Ugrai (Bese ‘63)

Shqiperia: Teqja, Fejzullahu, Prenci, Gjokaj, Kotobelli, Bunjaku (61’ Muriqi), Shala, Kace, Gino (‘76 Batha), Kruja (‘81 Bardulla), Shkurtaj.

Trajner: Skender Gega

U21/ Hungari – Shqiperi 0-2

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 14 Nentor 2013 20:37

Shenues: '75 Shkurtaj, Shala '83

Kartona te verdhe: Bunjaku, Shala